



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Numri i lëndës: 2024:005981
Datë: 19.03.2024
Numri i dokumentit: 05470163

2024:005981

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtaren Blerina KURTAJ dhe me bashkëpunëtoren profesionale Ardiana Nikollbibaj Thaqi, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditëses L.S., nga Gjakova, të cilën sipas autorizimit e përfaqëson Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, vlera e kontestit 990.75 Euro, jashtë seance me datë 19 mars 2024 mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET e bazuar kërkesëpadia e paditëses L.S., nga Gjakova dhe DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, që paditëses të lartcekur në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në vlerë prej 27% të pagës bazë për 25 muaj të licencimit dhe atë për periudhën kohore nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, të ia paguajë shumën prej 973.75-€ (nëntëqind e nëntëdhjetë euro e shtatëdhjetë e pesë cent), me kamatë ligjore prej 8%, e cila do të llogaritet nga data 19.12.2023 (data e paraqitjes së padisë), e deri në pagesën definitive, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, e nën kërcënim të përmbarimit.

II. REFUZOHET e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditëses mbi shumën e aprovuar sikurse në dispozitivin nën I të këtij aktgjykimi e deri në shumën e kërkuar dhe atë në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, në shumën prej 17.00-€.

III. DETYROHET e paditura Komuna e Gjakovës - Drejtoria e Arsimit, në emër të shpenzimeve të procedurës, paditëses të ia paguaj shumën prej 124.00.-€ (njëqind e njëzetë e katër euro) në afat prej 7 ditëve, nga dita e marrjes së aktgjykimit, e nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Paditësja L.S., nga Gjakova, në këtë gjykatë me datë 19.12.2023, përmes të autorizuarit të saj Ylli Bokshi, avokat në Gjakovë, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Gjakovës – Drejtoria Komunale e Arsimit, për kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, duke theksuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, në Institucionin Arsimor “...” në Gjakovë. E njëjta ka diplomuar në Fakultetin e Edukimit (Shkolla e lartë Pedagogjike - Gjakovë) Universitetin e Prishtinës, me datë 17.08.2012 dhe është e licencuar me Licencë të Karrierës, ndërsa me padi ka kërkuar që në emër të kualifikimit nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023, të i paguhet shuma në lartësi prej 990.75-€, po ashtu ka kërkuar kamatën ligjore, si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Gjakovës, përmes të autorizuarës së saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 31.01.2024, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar me arsyetimin se paditëses nuk i takon ky kompensim sepse nuk është përcaktuar me kontratën e punës të cilën kontratë e ka nënshkruar paditësja dhe është pajtuar me kushtet, detyrat dhe obligimet që i ka. Po ashtu, paditëses nuk i takon ky kompensim as me Ligjin e Punës numër 03/L-212 i cili rregullon kontestet e punës e ku askund nuk e parasheh që punëtorëve të arsimit iu takon kompensimi i tillë, prandaj kërkesës së paditëses i mungon baza juridike. Kontrata Kolektive në të cilën është thirrur paditësja nuk ka fuqi ligjore sepse është në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi. Kjo kontratë nuk është e nënshkruar nga Komuna e Gjakovës si autoritet i veçantë, respektivisht si njësi e vetëqeverisjes lokale si punëdhënës i vetëm i kësaj kategorie të punonjësve të arsimit. Po ashtu e njëjta është thirrur në parashkrim dhe në faktin se nuk janë shtjerrë të gjitha mjetet administrative dhe juridike sipas procedurës administrative të përcaktuar me nenin 78 par.1, 79 dhe 82 të Ligjit të Punës. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë dhe kërkesë padinë e paditëses ta refuzojë në tërësi si të pa bazuar.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 398 dhe 399 të LPK-së,

gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e paditëses është pjesërisht e themeltë dhe si e tillë pjesërisht u aprovua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqës të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës për paditësen L.S., e lëshuar nga Komuna e Gjakovës–Drejtoria Komunale e Arsimit, këtu e paditura, paditësja e lartcekur është në marrëdhënie pune tek e paditura në Institucionin Arsimor “...” në Gjakovë, si mësimdhënëse e lëndës së matematikës. Bazuar në Listat e pagave të lëshuara nga Buxheti i Republikës së Kosovës për periudhën 01.01.2021-31.01.2021, 01.01.2022-31.01.2022 dhe 01.01.2023-31.01.2023 vërtetohet fakti se paditësja realizon pagë bazë në lartësi prej 421.00 Euro, meqenëse e njëjta ka diplomuar me datë 17.08.2012 dhe ka marrë titullin Arsimtar i Matematikës, fakt që vërtetohet përmes Diplomës së lëshuar nga Universiteti i Prishtinës, Fakulteti i Edukimit (Shkolla e Lartë Pedagogjike-Gjakovë). Po ashtu paditësja ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës me numër 100022489. Gjkata konform nenit 329 par.1 të LPK-së, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*, provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre.

Gjkata gjen se në rastin në fjalë zbatohet Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, i cili vendim ka qenë në fuqi deri me datë 06.02.2023 ku është shfuqizuar me Ligjin për Pagat në Sektorin Publik numër 08/L-196. Sipas këtij vendimi, në pikën 1 është përcaktuar se *“Që nga data 01.09.2008 të gjithë mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional në shkollat e Republikës së Kosovës do të kenë rritje të pagave të tyre në bazë të kriterëve të licencimit”*, ndërsa pika 4 nën-pika 2 e tij, ka përcaktuar se *“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendësdrejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional, të pajisur me diplomë të shkollës së Lartë Pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%”*. Pasi që nga provat e lartcekura u vërtetua se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, se e njëjta ka diplomë me titull Arsimtar i Matematikës dhe ka licencë të rregullt dhe lloj të licencës të karrierës, rezulton se konform vendimit të lartcekur, paditëses i takon e drejta e kompensimit të të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, më konkretisht të pjesës së pa kompensuar lidhur me këtë të drejtë monetare për çdo muaj për periudhën kohore

nga data 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023 apo për 25 muaj, ashtu që për këtë periudhë paditëses i takon diferenca në shumën prej 973.75-€, për këtë kriter të kompensimit.

Duke qenë se kjo gjendje faktike nuk është kontestuese në mes të palëve, pasi që e paditura në asnjë formë nuk e ka kontestuar faktin se paditësja është e punësuar tek e paditura dhe se në periudhën prej datës 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023 të njëjtës për 25 muaj nuk i është kompensuar pjesa tjetër e shtesave në emër të kualifikimit, gjykata erdhi në përfundim se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance konform nenit 398 të LPK-së ku parashihet që *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seancë gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”*, për çka vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Gjykata vlerësoi pretendimin e të paditurës në lidhje me mungesën e bazës ligjore të kërkesëpadiisë me arsyetimin se Ligji i Punës nuk e ka paraparë pagesën e kompensimit për kualifikim, mirëpo këtë pretendim e refuzoi për shkak se baza e kërkesëpadiisë rrjedh nga Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008.

Sa i përket pretendimit të dhënë në përgjigje në padi se në rastin në fjalë kemi parashkrim të kërkesës në tërësi, ky pretendim rezulton i pabazuar sa i përket periudhës prej datës 01.01.2021 deri me datë 31.01.2023 pasi që konform nenit 87 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, i njëjti ka përcaktuar se *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, e që në rastin konkret duke pasur parasysh se padia është paraqitur me datë 27.12.2023, rezulton se për periudhën e lartcekur, padia është paraqitur brenda afatit prej tre viteve nga kur ka lindur e drejta për kërkesën nga marrëdhënia e punës.

Ndërsa sa i përket pretendimit lidhur me mungesën e buxhetit, edhe ky pretendim është i pabazuar dhe nuk gjen mbështetje në asnjë normë ligjore të aplikueshme, e për më tepër gjykata e vlerëson si të parëndësishme për të vendosur ndryshe në këtë çështje juridike kontestuese, pasi që paditësja nuk është përgjegjëse për planifikimin e buxhetit për obligimet që dalin nga Vendimi numër 01/33, andaj edhe rrethanat subjektive të të paditurës lidhur me mos planifikimin me kohë

të buxhetit për zbatimin e vendimit të lartcekur nuk e liron të njëjtën nga detyrimi për pagesën e këtyre shpenzimeve.

Lartësia e kamatës së përcaktuar prej 8%, i referohet nenit 382 të LMD-së dhe kamata është llogaritur nga dita e parashtrimit të padisë.

Sa i përket pjesës refuzuese gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e përfaqësueses ligjore të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, gjykata i mori pjesërisht si të bazuara dhe atë vetëm sa i përket periudhës kohore prej datës 01.03.2022 deri me datë 31.01.2023, pasi që nga provat që gjenden në shkresat e lëndës vërtetohet se paditësja kërkesën e saj për kompensimin në emër të kualifikimit për periudhën e lartcekur nuk ka prezantuar prova me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet e saj, përkatësisht lidhur me kompensimin e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, e po ashtu duke marr për bazë kualifikimin e paditëses dhe vendimin e Vendimi i Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 01/33 i datës 29.08.2008, ku parashihet sa i takon e drejta e kompensimit të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, gjykata vendosi si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktgjykimi, ashtu që për diferencën në emër të kompensimit për të ardhurat nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit në vlerën prej 19% të pagës bazë për 25 muaj, për çka gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se edhe në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK-së, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadië, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadië”,* ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadië është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadië qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.*

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën III të dispozitivit, gjykata e mori sipas nenit 449 dhe 452 par. 2 të LPK-së, duke pasur parasysh suksesin në procedurë, me ç ‘rast paditëses iu pranua shuma e shpenzimeve në vlerë prej 124.00.€. Lartësia e shpenzimeve të aprovuara i referohet shpenzimeve për pagesën e taksës gjyqësore në vlerë prej 20.00.-€ (të parapara sipas Udhëzimit Administrativ Nr.01/2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore), si dhe për përpilimin

e padisë shuma prej 104.00.-€, e paraparë sipas tarifës së Odës së Avokatëve të Kosovës Nr. Tarifor 6 dhe 17).

Prandaj, gjykata bazuar në arsyet e cekura më lartë, bazuar në nenin 143 lidhur me nenin 398 të LPK-së, vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË

Departamenti i Përgjithshëm

2024:005981, datë 19 mars 2024

Gj y q t a r j a,
Blerina KURTAJ

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes kësaj gjykate. Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.